REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke e konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke e vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2025 dhe vlerëson:

Rritjen e numrit të ankesave të paraqitura dhe të shqyrtuara, duke reflektuar intensifikimin e aktivitetit institucional dhe rritjen e përdorimit të mekanizmit administrativ të ankimit.

Pranimin e një pjese të konsiderueshme të ankesave, plotësisht ose pjesërisht, çka reflekton rolin aktiv të KPP-së në korrigjimin e shkeljeve dhe garantimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit.

Përmirësimin e treguesve të kohës së shqyrtimit të ankesave dhe reduktimin e përqindjes së rasteve të trajtuara jashtë afatit ligjor, ndonëse mbeten ende raste të trajtuara jashtë afatit procedural.

Qëndrueshmërinë e pjesës më të madhe të vendimeve të KPP-së në kontrollin gjyqësor, duke reflektuar konsistencë të praktikës administrative të institucionit.

Identifikimin e problematikave të përsëritura në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe në vlerësimin e ofertave, të cilat vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të kontestimeve administrative.

Referimin e rasteve për hetim administrativ dhe në organet e ndjekjes penale duke reflektuar funksionin mbikëqyrës dhe evidentues të institucionit ndaj shkeljeve të konstatuara.

Zhvillimin e projekteve të rëndësishme të digjitalizimit dhe publikimit të të dhënave sipas standardeve ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe aksesit publik.

Zgjerimin e përdorimit të sistemeve elektronike dhe mekanizmave digjitalë në procesin e shqyrtimit administrativ dhe komunikimit me operatorët ekonomikë.

Kuvendi kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vitit 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë përmirësimin e aksesueshmërisë dhe efektivitetit të mekanizmave të ankimit administrativ, duke përfshirë në raportimet vjetore në vijim informacionin për masat e ndërmarra për reduktimin e rasteve të refuzimit të ankesave për shkaqe procedurale dhe për rritjen e përdorimit të shërbimeve elektronike nga operatorët ekonomikë.

2. Të forcojë monitorimin dhe transparencën e procesit të zbatimit të vendimeve të Komisionit, duke raportuar periodikisht çdo 6-muaj në Kuvend për nivelin e zbatimit, problematikat e evidentuara dhe zhvillimet kryesore të praktikës vendimmarrëse, përfshirë çështjet me interes të veçantë dhe interpretimet ligjore me ndikim në konsolidimin e praktikës administrative.

3. Të përmirësojë më tej respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë institucionale dhe të raportojë në Kuvend, brenda muajit dhjetor, për faktorët që ndikojnë në tejkalimin e tyre.

4. Të rrisë rolin orientues dhe unifikues të institucionit në sistemin e prokurimit publik përmes publikimit periodik të vendimeve interpretuese, praktikave të konsoliduara dhe udhëzimeve orientuese, me synim garantimin e një zbatimi sa më të njëtrajtshëm të legjislacionit nga autoritetet kontraktore.

5. Të ndërmarrë masa për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe plotësimin e strukturës së miratuar organizative, duke raportuar në Kuvend, brenda muajit dhjetor, për ecurinë e procesit të rekrutimit dhe ndikimin e tij në përballimin e ngarkesës së punës.

6. Të angazhohet për përmbushjen e plotë të standardeve të transparencës institucionale, në përputhje me Programin e Transparencës dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar publikimin sistematik dhe të përditësuar të informacionit me interes publik.

7. Të kryejë dhe t'i paraqesë Kuvendit, brenda muajit dhjetor, një analizë për ndikimin e tarifave të ankimit në aksesin efektiv të operatorëve ekonomikë në mekanizmat administrativë të mbrojtjes juridike, duke marrë në konsideratë praktikat e vendeve të rajonit, standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë.

8. Në raportimet vjetore në vijim, të analizojë në mënyrë më të detajuar të dhënat mbi të ardhurat e krijuara nga tarifat e ankimit, shumat e kthyera operatorëve ekonomikë, si dhe kontributin neto të këtyre të ardhurave në buxhetin e shtetit, me qëllim rritjen e transparencës financiare dhe të llogaridhënies institucionale.

9. Të vijojë kontributin në procesin e harmonizimit të praktikës institucionale me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik, si dhe në raportimet vjetore në vijim të përfshijë informacionin për masat e ndërmarra për adresimin e rekomandimeve të progresraportit të Komisionit Evropian dhe raporteve të SIGMA/OECD.

10. Të kryejë një analizë të detajuar për faktorët që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik, duke evidentuar veçanërisht rastet e procedurave me një ofertë të vetme. Gjithashtu, të raportojë për masat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura për rritjen e konkurrencës, zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe garantimin e përdorimit sa më efikas të fondeve publike, duke ia përcjellë këtë analizë Kuvendit, brenda muajit tetor 2026.

11. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

12. Të paraqesë pranë Kuvendit, brenda dhjetorit 2026, një analizë të praktikës gjyqësore lidhur me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, duke evidentuar përqindjen e vendimeve të lëna në fuqi, të ndryshuara ose të shfuqizuara, arsyet kryesore të kontrollit gjyqësor dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e cilësisë dhe konsistencës së vendimmarrjes.

13. Të konsolidojë mekanizmat e transparencës institucionale, duke forcuar funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe duke garantuar publikimin e informacionit sipas standardeve të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

14. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo 4 muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre, në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

15. Të pasqyrojë në mënyrë të veçantë në raportimet vjetore masat e ndërmarra për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, rezultatet e arritura në zbatim të detyrimeve ligjore përkatëse, bashkëpunimin institucional me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe zbatimin efektiv të vendimeve të tij.

Miratuar në datën 30.6.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi